



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI**

**VENDIM**

**Nr. 398, Datë 28.12.2023**

**MBI**

**PËRFUNDIMIN E PROCEDURËS ADMINISTRATIVE PËR HEQJEN E LICENCËS  
PËR VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE DHËNË  
SHOQËRISË “REKA ENERGY” SH.P.K.**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 95 dhe 113 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; neneve 7, 8 dhe 9 të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 58, datë 18.04.2017; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 28.12.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2311/2 prot., datë 22.12.2023, të përgatitur nga Grupi i Punës “Mbi përfundimin e procedurës për heqjen e licencave të subjekteve debitoare për pagesat e rregullimit të vitit 2023 të pashlyera ndaj ERE-s”

**Konstatoi se:**

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 334, datë 14.11.2023, vendosi fillimin e procedurës për heqjen e licencës për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “REKA ENERGY” sh.p.k.,
- Vendimi nr. 334/2023 u mor për arsye se shoqëria nuk kishte shlyer në afat ndaj ERE-s pagesën rregullatore të vitit 2023 për licencën për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike e po ashtu nuk kishte depozituar asnjë dokument apo argument në lidhje me moszbatimin e këtij detyrimi.
- Me shkresën nr. 1615/2 prot., datë 21.11.2023, shoqëria është njoftuar për vendimin e bordit të ERE-s nr. 334/2023, duke i bërë me dije se ka të drejtën për t’u përgjigjur me shkrim brenda 30 ditëve nga data e marrjes së këtij njoftimi.
- Nga rakordimet/verifikimet në gjendjen e llogarisë bankare (statement) të ERE-s rezulton se kjo debi është shlyer në datën 19.12.2023.
- Referuar afateve të përcaktuara nga ERE në njoftimin e dërguar subjektit, rezulton se shoqëria “REKA ENERGY” shpk i ka shlyer detyrimet e prapambetura brenda afatit dhe nuk është më debitoare ndaj ERE-s.

- Në nenin 9, gërma “a” të “Rregullores për procedurat e heqjes së licensave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.04.2017 parashikohet se: *Me marrjen e informacionit të detajuar me të dhënat sipas nenit 7 dhe 8 të kësaj rregulloreje, Bordi do të vendosë për mbylljen e procedurës për heqjen e licencës.*
- Në nenin 95 të “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, parashikohet se: *Organi publik deklaron të përfunduar procedurën administrative pa një vendim përfundimtar për çështjen, kur objekti për të cilin kishte nisur procedura apo qëllimi i tij është bërë i pamundur. Qëllimi i procedurës administrative, në kuptim të kësaj dispozite, është bërë i pamundur për shkak të ndryshimit të rrethanave faktike dhe shlyerjes në masën 100% vlerës së debisë nga shoqëria “REKA ENERGY” sh.p.k.*
- Vërtetimi i shlyerjes së pagesës të prapambetur, faktin ndryshimin e statusit të subjektit të cilit i kundrejtohet masa administrative, duke rezultuar në rënien e shkakut që çoi në marrjen e masës për fillimin e procedurës për heqjen e licencës, dhe duke qenë se objekti për të cilin filloi procedura për heqjen e licencës së të licencuarit nuk ekziston më, vlerësohet përfundimi i procedurës për heqjen e licencës dhe shfuqizimi i vendimit të bordit të ERE-s nr. 334/2023.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

#### **Vendosi:**

1. Të përfundojë procedurën administrative për heqjen e licencës për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “REKA ENERGY” sh.p.k.
2. Të shfuqizojë vendimin e bordit të ERE-s nr. 334, datë 14.11.2023.
3. Grupi i Punës, të njoftojë shoqërinë “REKA ENERGY” sh.p.k. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Petrit AHMET**